

VENDIM
Nr.202, datë 20.12.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO DURRËSI”
SUBJEKTIT “RADIO DURRËSI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënie e licencave për transmetime televizive dhe radion FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.97, datë 27.8.2010 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Radio Durrësi” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për të mbuluar me sinjal prefekturën Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati